



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 9092 Prot.

Lezhë, më 05 . 05 .2021

VENDIM

Nr. 88 Datë 30 . 04 .2021

“PËR  
PËRFUNDIMIN E PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË BANESAVE, TË CILAT  
KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË AGJENCINË SHTETËRORE TË  
KADASTRËS ”

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 64, ligjin nr. 9232 date 13/05/2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndryshuar, ligjin nr. 7652 date 23/12/1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” dhe ligjit nr. 9321 datë 25/11/2004 “Për privatizimin e banesave shtetërore dhe objekteve, të kthyer në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

V E N D O S I :

1. Të përfundohen procedurat e privatizimit të apartamenteve për lidhjen e kontratave të shitblerjes para noterit, për banesat të cilat kanë mbetur pa u regjistruar pranë ASHK-së, sipas listës më poshtë :

Zef Jak Milloshaj , Banesa nr.18 , Rruga Rrilë , Shkalla 1, Kati 2 , Rrilë Lezhë .

2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar prej tij, për lidhjen e kontratës së privatizimit para noterit .
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI

ERNEST RAKAJ

